

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.Nr.114/2022

Datë: 10 mars 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke shqyrtuar çështjen disiplinore ndaj Ylber Shurdhiqi, Gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil në Gjykatën e Apelit, sipas kërkesës ADGJA.nr.02/2022, të datës 09.03.2022, të Autoritetit Kompetent për fillimin e hetimeve disiplinore, në pajtim me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Ligji Nr.08/L-003 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e 280-të, të mbajtur me 10 mars 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **SUSPENDOHET** nga detyra e gjyqtarit Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil në Gjykatën e Apelit, deri në një vendim tjetër të Këshillit.
2. Gjatë kësaj periudhe gjyqtari Ylber Shurdhiqi, do të pranoj vetëm 50% të pagës mujore.
3. Ky vendim hyn në fuqi me datë 10 mars 2022

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 10 mars 2022, ka mbajtur takimin e 280-të, në të cilën ka shqyrtuar kërkesën e Autoritetit Kompetent për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil në Gjykatën e Apelit.

Pas shqyrtimit të kërkesës për fillim të hetimit disiplinor, bazuar në nenin 11 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka themeluar Panelin Hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore. Paneli përbehet prej tre (3) gjyqtarëve, të cilët janë zgjedhur me short dhe të cilët vijnë nga gjykatat tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtarja që do të hetohet.

Më tutje, Këshilli në kuptim të dispozitës së nenit 2, të Ligjit Nr.08/L-003 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcaktuar se “Gjatë procedurës hetimore, Këshilli ex officio ose me kërkesë të Autoritetit Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, mund të suspendojë gjyqtarin ose prokurorin i cili është nën hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes së supozuar disiplinore dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve”, sipas detyrës zyrtare e ka shqyrtuar dhe vlerësuar çështjen e suspendimit të gjyqtarit në fjalë dhe pas diskutimeve në mënyrë unanime ka vendosur për suspendimin e gjyqtarit.

Këshilli ka vlerësuar se suspendimi i gjyqtarit në këtë fazë të procedurës do të krijojë parakushte që Paneli Hetimor ta hetojë në tërësi çështjen në mënyrë objektive duke pamundësuar çfarëdo ndikimi në procedurën disiplinore.


Suspendimi i gjyqtarit nuk prejudikon mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe as përfundimin e procedurës, por e lehtëson procesin e hetimit disiplinor.

Në çdo rast kur Këshilli vendos që gjyqtari të suspendohet, atëherë në kuptim të nenit 12 paragrafi 10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, gjyqtari do të pranoj 50% të pagës mujore, prandaj edhe në këtë rast gjyqtarit në fjalë i takon kompensimi 50% e pagës mujore.

Nga të cekurat me lartë, dhe në kuptim të nenit 12 paragrafi 10, dhe nenit 2 të Ligjit Nr.08/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.114/2022, datë: 10 mars 2022

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Afrim Shala, u.d, i Kryetarit të Gjykatës së Apelit;*
- *Ylber Shurdhiqi, Gjyqtar, Gjykata e Apelit;*
- *Arkivit.*